



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 25/08

Prishtinë, më 9.10.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Kosara Nikolić, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj Xhevdet Neziraj, Naser Osmani.

Anëtarët jo të pranishëm: Müfera Şinik dhe Behxhet Pacolli.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi, Drejtor për buxhet pranë MEF-it, Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Ali Hamiti nga ZRRE, Fatmir Uka nga ZAGJ, Halit Muharremi nga KGJK, Tek Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, NDI, KDI, ICO/EFAU.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhje e dt. 29 shtator 2008**
3. **Shqyrtimi i kërkesave buxhetore për vitin 2009 të organizatave buxhetore në vijim:**
 - 3.1. **Kuvendi i Kosovës**
 - 3.2. **Zyra e Rregullatorit të Energjisë**
 - 3.3. **Zyra e Auditorit Gjeneral**
 - 3.4. **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi, njoftoi për zëvendësimin e një anëtari të Komisionit, me propozimin e grupit parlamentar të LDK-së, në vend të Aremnd Zmaj është caktuar Naser Osmani. Më pas kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e datës 29 shtator 2008

Hajdin Abazi, theksoi se në pikën të ndryshme, në diskutimin tij është bërë një gabim, është shënuar fjala “mosbotim” e duhet të jetë “mosvotim”. Kërkoi që të përmissohet ky lëshim teknik.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali i datës 29.09.2008, miratohet me vërejtjen e z. Abazi.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore për vitin 2009 të organizatave buxhetore në vijim:

3.1. Kuvendi i Kosovës

Kryesuesi, duke komentuar kërkesën e buxhetore të Kuvendit të Kosovës dhe vendimin Kryesisë së Kuvendit, theksoi se në këtë proces buxhetor, Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është konsultuar fare dhe në këtë mënyrë me këtë veprim është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit, e cila parashihet kompetencat e komisionit për pjesëmarrje aktive në përgatitjen e buxhetit të Kuvendit. Përgjegjës për këtë janë Kryesia dhe përgatitësit e administratës së buxhetit. Ndërsa duke folur për kërkesat e organizatave tjera buxhetore, shifet në përmbajtjen e tyre shumë janë dyfish më të larta se vitin e kaluar. Prandaj lidhur me këtë dhe procesin buxhetor në përgjithësi, kufijtë e tij për vitin 2009, kërkoi informacione nga drejtori i buxhetit z. Krasniqi.

Agim Krasniqi, njoftoi se procesi i përpilimit të buxhetit është në fazën përfundimtare. Megjithatë ende nuk janë rumbullakuar kufijtë e fundit buxhetor, të cilat do të finalizohen brenda afatit të paraparë. Duke komentuar strukturën e kategorive ekonomike, theksoi se kategoria mallra dhe shërbime do të kenë zbritje, shpenzimet operative duhet mbetur të tilla deri në rishikim të buxheti, gjithashtu rritet kufiri i shpenzimeve kapitale (të cilat kryesisht do të financohen nga fondi i donacioneve - 620 milion €). Ndërsa nuk do të ketë bartje të mjeteve për vitin 2009, me përjashtim të projekteve të kontraktuara.

Sa i përket shpenzimeve, kostoja e krijimit të institucioneve pas statusit është lënë jashtë rregullimit fiskal (shpenzimet për Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Forcës së Sigurisë, Gjykatën Kushtetuese, Procesin e Privatizimit me një kosto totale prej 60 milion €). Z. Krasniqi njoftoi për takimet e frytshme që kanë pasur me FMN, dhe janë pajtuar me rekomandimin e tyre për krijimin e një rezerve qeveritare me qëllim të ruajtjes së likuiditetit buxhetor. Një praktikë e mirë që është bërë këtë vit, është kërkesa prej organizatave buxhetore që të bëjnë projeksionet buxhetore edhe për vitet 2010 dhe 2011. Më tutje vazhdoi se bazë e përgatitjes së buxhetit 2009 ka qenë viti 2008, dhe në këtë drejtim është analizuar edhe buxheti i vitit 2007. Krahasimet e bëra me vitin paraprak tregon se kufiri i shpenzimeve është më i ultë. U shpreh optimist se asnjë organizatë buxhetore me këto projeksione nuk do të ketë problem në ekzekutimin e buxhetit të tyre.

Haki Shatri, pyeti për kufijtë e buxhetit deri më tani në të gjitha kategoritë ekonomike.

Agim Krasniqi, lidhur me pyetjen e parafolësit, përsëriti se kufijtë nuk janë final. Megjithatë tregoi se deri më tani struktura e totale e buxhetit është 1 miliard e 64 milion €. Për paga dhe mëditje janë paraparë 223 milion €, për mallra dhe shërbime 183 €, për rezerva 6 milion €, shpenzime kapitale 370 milion €. Njoftoi se pas takimeve me FMN, janë pajtuar që strukturën e shpenzimeve për mallra dhe shërbime të zbritet për 15 %.

Safete Hadërgjonaj, duke u ndërlidhur me diskutimet, theksoi se nuk po bisedohet për buxhetin e përgjithshëm, por për kërkesat buxhetore të disa organizatave buxhetore, prandaj edhe kërkoi që përqendrohen në përmbajtjen e atyre kërkesave. Ndërsa falënderoi drejtorin e buxhetit për informacionet e mjaftueshme rreth përgatitjes së procesit të përgjithshëm buxhetor.

Besa Gaxheri, pyeti drejtorin e buxhetit se a janë të përcaktuar kufijtë buxhetor për kategoritë ekonomike të Kuvendit (paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime kapitale).

Kosara Nikolić, bëri vërejtje për mosmarrjen e materialit në gjuhën serbe dhe si rezultat ajo duhet të mbetet pasiv në diskutim.

Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës, prezantoi buxhetin e Kuvendit duke lexuar shifrat për kategoritë ekonomike. Lidhur me shpenzimet kapitale, theksoi se është planifikuar të vazhdojnë punimet në qendrën protokolare “gërmia”, ndërsa nëse nuk punohet, mjetet në rishikim do t’i kthehen buxhetit të përgjithshëm. Megjithatë z. Krasniqi kërkoi që dy pozicione buxhetore të parapara në kuadër të buxhetit të Kuvendit të trajtohen ndryshe dhe ndaras nga buxheti i Kuvendit. Të trajtohet ndryshe “Fondi për demokratizim”, që përfshin mjetet për partitë politike. Si dhe buxheti i “Këshillit Pavarur Mbikëqyrës” (me urdhëresë administrative të PSSP-së është futur si organ i Kuvendit). Më tutje sekretari vazhdoi duke thënë se në të kaluarën kanë ekzistuar tre kode buxhetore: kodi i kryetarit të Kuvendit, kodi i deputetëve dhe kodi i administratës. Kodi i kryetarit është fuzionuar. Si rezultat i kësaj numri i punëtorëve të administratës është rritur, pas që asistentë dhe zyrtarët e stafit politik kanë mbetur stafi i administratës së Kuvendit dhe në këtë formë është rritur numri i puntërove, si rezultat i së cilës paraqite problemet me pagesën e tyre. Në këtë drejtim kërkoi që buxheti i stafit politik të jetë i ndarë me atë të stafit administrativ. Lidhur me propozimin (vendimin) e Kryesisë për mjete shtesë, theksoi se është proceduar nga Kryesia dhe është objekt diskutimi nga ky Komisioni

Kryesuesi, në përmbajtjen e kërkesës së Kryesisë, theksoi se ideja për hapjen e zyrave ka ekzistuar edhe më herët, ndërsa tani është aktualizuar. U pajtua se duhet të hapen ato, por duhet hapur një zyre për deputetët regjional të të njëjtës parti. Ndërsa lidhur me transportin e deputetëve duhet që të jetë i organizuar, kurse për vetura të mendohet mirë pasi paraqesin luks.

Naser Osmani, duke komentuar kërkesën buxhetore të Kuvendit, theksoi se Komisioni dhe organet e Kuvendit duhet bëjnë debat për çështjet e tyre para se të takohet me Qeverinë. Lidhur me vendimin e Kryesisë nuk mund të debatohet për arsye se para vetit kemi një vendim e jo propozim. Kjo mënyrë e procedimit të buxhetit të Kuvendit, duke anashkaluar kompetencat e këtij Komisioni dëshmon shkeljen e Rregullores së Punës së Kuvendit. Ndërsa lidhur përmissimin e kushteve të deputetëve theksoi se duhet përmissuar ato. Deputetë duhet të kenë privilegje dhe kushte normale për punë sepse janë të zgjedhurit e popullit dhe punojnë për interesat e tyre. Duhet sigurohet zyra në ndërtesën e Kuvendit, e pastaj edhe në qendrat prej nga vijnë, njëkohësisht të mundësohet kontakti me elektoratin në të gjitha pjesët vendit. Bëri vërejtje për kërkesën e Kryesisë, që Komisioni për buxhet dhe financa të jetë i barabartë gjatë shqyrtimit të buxhetit me komisionet tjera, që paraqet një shkelje tjetër të Rregullores për kompetencat e veçanta që ka ky komision lidhur me buxhetin. Kritikoi mediat të cilat në disa raste nuk kanë pasqyruar të vërtetën me Parlamentin dhe kanë devaluuar institucionin më të lartë të vendit.

Safete Hadërgjonaj, u pajtua me mendimet se mënyra se si është proceduar dhe parashtruar buxheti i Kuvendit në Komision për diskutim, tregon shkelje të Rregullores. Në të kundërtën po të përfillej rregulla 6.7 e Rregullores së Punës së Kuvendit, që mundëson qasjen e drejtpërdrejtë të këtij komision në procesin e përgatitjes së buxhetit të Kuvendit, do të mund të ishin harmonizuar qëndrimet dhe nuk do të ishin shfaqur këto mospajtime lidhur hartimin e buxhetit të Kuvendit. Znj. Hadërgjonaj theksoi se një defekt që i përfshinë të gjitha Agjencione buxhetore është planifikimi jo i mirë i buxhetit të tyre (mungesa e dokumenteve përcjellëse të specifikuara), e që po ndikon në mosrealizimin e tij nga këto organizata. Para së të përgatitet buxheti, është dashur që të zhvillohet një debat në mes grupeve parlamentare dhe komisioneve parlamentare me rolin kyç të komisionit për buxhet dhe financa. Duke komentuar kërkesë që edhe komisionet tjera parlamentare të shqyrtojnë buxhetin, theksoi se nuk është kundër, por me kusht që propozimet apo amendamentet eventuale të tyre, të shqyrtohen dhe miratohen nga ky komision. U pajtua me mendimet se duhet krijohen kushte për punë për deputetë dhe jo beneficione të tepruara. Të kemi një zyrë për punë në Kuvend si dhe të mendohet në hapjen e zyrave regjionale. Për dallim për privilegjet për Kryesinë, më mirë do të ishte të përkrahet puna e komisioneve. Kërkoj të dhëna më të qarta lidhur me mjetetet e parapara për diplomaci parlamentare. Gjithashtu u pajtua që fondi për demokratizim të kalojë në kuadër të buxhetit e Komisionit Qendror Zgjedhor. Prandaj duke qenë kundër miratimit të kërkesës së Kryesisë dhe buxhetit të Kuvendit për shkak mënyrës së procedimit, kërkoj që debati të vazhdoj deri në përmbylljen e procesit të përgjithshëm buxhetor. Në këtë drejtim të koordinojnë punët Kryesia, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe administrata e Kuvendit.

Besa Gaxherri, theksoi në bazë të procedimit të buxhetit të Kuvendit dhe mënyrës së parashtrimit të kërkesës së Kryesisë, nuk ia vlen të diskutohet fare. Me arsyetimin se është shkelur Rregullorja e punës duke u anashkaluar Komisioni për buxhet dhe financa, kompetent për këto çështje. Nga Propozimi i Kryesisë shohim kërkesat lukse për anëtarët e Kryesisë, ndërsa për deputetë nuk është planifikuar as përmasimi i kushteve minimale për punë. (mungojnë zyret, transporti, pjesëmarrje në katër komisione ndërsa pagesa vetëm për një). Duke analizuar strukturën buxhetore, shpenzimet kapitale duken qesharake. Pjesë e këtyre investimeve janë planifikuar projektet e papërfunduar që disa vite (renovimit të ndërtesës, rregullimi i resturantit). Në vazhdim duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Agim Krasniqi lidhur me atë se nuk do të ketë bartje të mjeteve këtë vit, znj. Gaxherri pyeti se sa do të ketë suficit sepse një gjë e tillë dihet se do të ndodh. Ndërsa lidhur me projektet kapitale të parapara si të financuara nga fondi i donacioneve pyeti se a është planifikuar se sa do të financohen nga ky fond dhe sa nga buxheti i Kosovës. Duke qenë kundër kërkesës së Kryesisë, kërkoj që Komisioni të punojë profesionalisht dhe në bazë të kompetencave që i garantohen me rregullore dhe të bie propozime konkrete me të cilin duhet parashihet krijimi e kushteve për punë normale për deputetë.

Shkumbin Demaliaj, lidhur me vendimin e Kryesisë për rritjen e privilegjeve, tha se është i papranueshëm. Ndërsa sa i përket vendimit të Kryesisë i cili është medializuar aq shumë me komentimet se buxheti i Kuvendit parashih privilegje për deputetë, nga përmbytja e saj shifet se nuk mund të flitet për privilegje, përkundrazi nuk janë parashikuar as plotësimi i kushteve minimale për punë. Përkujtoi edhe krijimin e nënkomisionit për të parashtruar kërkesat dhe nevojat e arsyeshme të deputetëve, të cilat është dashur të përfshihen në buxhetin e Kuvendit për vitin 2009. Prandaj një projektbuxhet i tillë i propozuar tregon se nuk mund të flitet për privilegje të deputetëve (ajo që është publikuar në media ka qenë e keqinterpretuar), përkundrazi po humbet dinjiteti i deputetit.

Xhevdet Neziraj, theksoi se është ndier i zhgënjyer për marrjen e informacionit nga mediat për vendimin e Kryesisë për buxhetin e Kuvendit, e që në fakt për këtë është dashur që të informohet nga Komisioni. Duke komentuar gjendjen aktuale të buxhetit të Kuvendit, theksoi se për disa

deputetë po bëhen diskriminime. Sidomos për atë që jetojnë jashtë Prishtinës. Z. Neziraj theksoi se ai është i angazhuar në dy komisione kryesore ndërsa paguhet vetëm për njërin. Gjysma e pagës që merr shkon për shpenzime të rrugës. Kritiko i mediat të cilat për mosifnormimit të drejtë, me deklaratat e tyre janë bërë fyerje të deputetëve, e që nga buxheti i hartuar shifet se, jo që nuk janë siguruar privilegje por as edhe kushte normale për punë. Gjithashtu kritiko i për anashkalimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa në pjesëmarrjen aktive gjatë hartimit të buxhetit të Kuvendit.

Myrvete Pantina, duke u ndërlidhur me vendimin e Kryesisë shohim se është bërë një hap i ngutshëm dhe se këto kërkesa janë të paarsyeshme. Shifet se është bërë shkelje e Rregullores, duke anashkaluar komisionin në qasjen e tij aktive rreth miratimit të buxhetit të Kuvendit. Po të analizojmë kërkesat e vendimit të Kryesisë shohim se disa prej tyre janë tepër luksoze dhe të papërbalueshme me rrethanat në të cilat jetojmë, në veçanti propozimi për blerjen e veturave. Kërko i sqarim për shumën 500 000 € për shërbime konsulente, po ashtu edhe për shumën prej 1 000 000 € për Kryesinë. Znj. Pantina u pajtua me propozimet se duhet bërë përmisimin e kushteve të deputetëve për punë normale, (sigurimin e zyrës në Kuvend, të hapen zyret në regjionin prej nga vijnë deputetët, të kompensohet shpenzimet e transportit të deputetëve, varësisht prej relacioneve që udhëtojnë konform mundësive buxhetore).

Hajdin Abazi, kritiko i mediat për keqinformim rreth vendimit të Kryesisë duke e publikuar si vendim që mbështet kërkesat e deputetëve. U pajtua me mendimet për shkeljen e Rregullores si rezultat i shmangies së komisionit në procesin e hartimit të buxhetit të Kuvendit. Kërko i sqarim për kërkesën e pestë, ndërsa duke komentuar kërkesën e gjashtë theksoi se shumatat e parapara janë të larta. Gjithashtu u pajtua me mendimin se Komisioni për buxhet dhe financa nuk do të duhej të ishte i barabartë me komisionet tjera në shqyrtimin e buxhetit sepse devalvon punën e këtij komisioni. Përkrahu mendimet e parafolësëve se duhet përmisuar kushtet për punë normale për deputet e jo sigurimin e privilegjeve siç është medializuar. Kërko i të zgjidhet problemi i zyreve në Kuvend dhe në regjion prej nga vijnë deputetët. Të zgjidhet problemi i mëditjeve për pjesëmarrje në punën e dy a më tepër komisioneve.

Kosara Nikolić, theksoi se nuk mund të flas për pjesën tekstuale për shkak të mungesës së materialit në gjuhën serbe. U pajtua me diskutimet e parafolësëve për shkeljen e Rregullës 6.7 të Rregullores së punës së Kuvendit si rezultati i shmangies së Komisionit për buxhet dhe financa në hartimin e buxhetit të Kuvendit. Gjithashtu u pajtua me mendimet se deputetët ka nevojë për kushte për punë normale. Përmendi rastin kur në një vizitë pune ka shpenzuar paratë e saj për telefon kur dihet se në këto vizita prezantohet Kosova. Nevojë e domosdoshme sigurimi i zyreve në komunat prej nga vijnë deputetët me qëllim të kontaktimit me elektoratin. Kërko i nga Komisioni të merr një qëndrim, në të cilin duhet merren parasysh edhe nevojat për punë normale të deputetëve.

Armend Zemaj, lidhur me kërkesat për përmisimin e kushteve të deputetëve tha se është hera tretë që bisedohet. Për këtë qëllim është krijuar edhe nënkomisioni me pëlqimin e kryeparlamentar, por pa asnjë rezultat. Me kërkesat e Kryesisë (sigurimi i një këshilltari, asistenti) është i njohur Komisionin, të cilat janë refuzuar me rastin e rishikimit të buxhetit. Ndërsa sa i përket përmisimit të kushteve të deputetëve, ato duhet bërë. Duhet siguruar edhe veturat por ato të jenë pronë e Kuvendit dhe të shfrytëzohen në bazë të nevojës. Gjithashtu duhet siguruar zyra për punë në Kuvend.

Haki Shatri, përshëndeti praninë e medieve për t'u informuar drejtë lidhur me çështjen e buxhetit të Kuvendit, që është medializuar shumë. U pajtua me mendimet që deputetët duhet të kenë kushte më të mira për punë, sidomos sigurimi i zyrave në Kuvend. Gjithashtu edhe zyrave në komuna por të jenë të përbashkëta për deputetët e të njëjtës parti. Për makina tha se ende nuk e ka shumë të

qartë. Për shpenzimet për karburant të precizohet më mirë (ata që kompensohen për rrugë të mos marrin edhe për karburant). Duke parë shumë paqartësi lidhur me kërkesat e Kryesisë, lind nevoja për rishqyrtim të saj dhe buxhetit të Kuvendit.

Kryesuesi, pyeti se qfarë është menduar për shumën për fondin për diplomaci. Të bëhen sqarime për shumën prej 1 milion eurosh për Kryesinë, po ashtu edhe për shumën prej 500 000 për shërbime konsulente. U pajtua me propozimin që të ndahet buxheti i stafit politik nga ai administrativ. Gjithashtu kryesia të ketë linjën e veçantë buxhetore. Bëri vërejtje për përcaktimin e këshilltarëve për Kryesinë, ndërsa jo për Komisionet që kanë më tepër nevojë, për këto çështje kërkoi sqarime nga zyrtarët e administratës.

Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës, duke i'u përgjigjur pyetjes për fondin për diplomaci parlamentare, theksoi se është menduar që të bëhen vizita reciproke ndërparlamentare dhe krijimi i grupeve të miqësisë me vendet që kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Bartës të këtyre vizitave të jenë Kryesia dhe Komisioni për Punë të Jashtme. Prandaj në këtë kontekst është menduar që pranohen ftesat e jo edhe të bëhet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve. Për shërbime të konsulentë është menduar në angazhimin e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, për nevoja të Kuvendit dhe Komisioneve parlamentare.

Kryesuesi, propozoi që të krijohet një grup punes, i cili do të rishqyrtoj edhe njëherë buxhetin e Kuvendit dhe vendimin Kryesisë dhe të del me propozime konkrete dhe të pranueshme për komisionin.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

Q ë n d r i m

- I. Me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve në mes Kryesisë së Kuvendit, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Administratës së Kuvendit lidhur me projektbuxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2009, Komisioni krijoi grupin punues.
- II. Obligohet grupi punues, në afatin sa më të shkurtër do të bëjë propozimet përfundimtare lidhur me projektbuxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2009.

Anëtarët e grupit punues janë:

1. Ibrahim Gashi (anëtar i Kryesisë së Kuvendit)
2. Džezair Murati (anëtar i Kryesisë së Kuvendit)
3. Haki Shatri (Zëvendëskryesuesi i pare i KBF)
4. Kosara Nikolic (zëvendëskryesuese e dytë e KBF)
5. Besa Gaxherri (anëtare e KBF)
6. Safete Hadërgjonaj (anëtare e KBF)
7. Shkumbin Demalija (anëtar e KBF)
8. Xhevedet Neziraj (anëtar e KBF)
9. Ismet Krasniqi (sekretar i Kuvendit)
10. Mentor Osmanaj (udhëheqës i divizionit për buxhet dhe pagesa - Administrata e Kuvendit)

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore për vitin 2009 të organizatave buxhetore në vijim:

3.2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Kryesuesi, theksoi se nga projektbuxheti i propozuar nga ZRRE-ja në këtë vit, shifet se nuk dallon nga viti 2008. Për më tepër kërkoi sqarime nga përfaqësuesit e ZRRE-së.

Ali Hamiti, shpejtoi buxheti i ZRRE-së financohet nga të hyrat nga licencat. Në këtë vit nga këto të hyra do të kemi një suficit prej 800.000 € Z. Hamiti theksoi se në draftbuxhetin e dorëzuar për shqyrtim dhe miratim, janë bërë disa ndryshime. Përfshin kategorinë subvencione dhe transfere (heqja e shumës prej 12,500), paisja me IT është hequr sepse është planifikuar të bëhet me një projekt të veçantë si dhe zbritja e shumës shërbime intelektuale dhe këshillëdhënëse (në 287,000.00).

Agim Krasniqi, bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të gjitha Agjensionet duhet t'iu nënshtrohen procedurave buxhetore. Prandaj është edhe kërkesë e FMN-së, që të gjitha Agjensionet buxhetore të trajtohen dhe përfshihen në kuadër të buxhetit të përgjithshëm. Buxheti i lejuar momentalisht nga MEF-i për ZRRE, është në shumën prej 485.000 € MEF-i lidhur me këtë agjension ka vërejtje sa i përket investimeve kapitale që duhet arsyetohen në bazë të programit PIP, pastaj për suficitin që mendohet të bartet në vitin vijues që nuk e lejon ligji nuk lejon bartjen, për pjesëmarrje në mbledhjet e bordit dhe komisioneve të caktohen një buxhet i realizueshëm. Kërkoi që të mendohet se si të trajtohet ky agjension, pjesë e buxhetit apo i ndarë nga ai.

Kryesuesi, mbështeti mendimin se ky agjension dhe të gjitha Agjensionet dhe institucionet tjera buxhetore duhet përgatisin buxhetin e tyre konform Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësisive.

Naser Osmani, duke komentuar kërkesat e Agjensioneve buxhetore të cilat i ka themeluar Kuvendi, theksoi se është punë delikate në zgjidhjen e problemeve të tyre. Prandaj theksoi se do të ishte mirë të mbahej një dëgjim i përbashkët e këtyre Agjensioneve me komisionin, pa ndërhyrjen e Qeverisë. Kjo do të rezultonte me shqyrtimin, analizimin e këtyre kërkesave dhe shumave të tyre. Në pyetjen se a duhet të jetë ZRRE-ja, pjesë e buxhetit apo jo, këtë çështje e rregullon Ligji.

Safete Hadërgjonaj, mbështeti idenë që të gjitha Agjensionet (edhe ato të pavarura) të jenë pjesë e buxhetit të përgjithshëm. Ndërsa lidhur me kërkesën e ZRRE-së bëri vërejtje se ajo nuk është specifikuar, nuk ka shifra për të shpjeguar rrjedhën e shpenzimeve (të paktën deri më 30 shtator). Shumat për paga bruto janë paraparë por nuk dihet për numrin e punëtorëve dhe hirearkin e tyre. Si rezultat i një situatë të këtillë, të mungesës së rrjedhës së shpenzimeve, theksoi se Komisioni nuk do të duhej të merrte vendim.

Haki Shatri, theksoi se ZRRE-ja është kategori kushtetuese, prandaj edhe buxhetin e përgatit në mënyrë të veçantë. U pajtua me mendimin se buxheti i këtij agjensionit të futet në kuadër të pasqyrave të përgjithshme buxhetore, por të lejet mundësia e përgatitjes së pavarur të tij. Të gjitha Agjensioneve duhet krijuar pavarësinë financiare sepse nga kjo varet veprimi i lirë i tyre. Megjithatë kërkoi që pjesa e pagave të harmonizohet me Ligjin e ri për ZRRE-në.

Besa Gaxherri, mbështeti mendimin për pavarësinë financiare që duhet gëzoj ky agjension, por të jenë të pavarur edhe në vendimet që marrin, mos të ndikohen nga Qeveria.

Hajdin Abazi, kërkoi të bëhet përcaktimi i hierarkisë së punëtorëve dhe në bazë të saj edhe të përcaktohen pagat.

Kryesuesi, theksoi se në bazë të Ligjit të ri, pagat e punëtorëve të këtij agjensioni, përcaktohen në bazë të kushteve të tregut (ndërmarrjeve publike). Prandaj propozoi që pagat e tyre të përcaktohen në raport me vendet e regjionit.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni shqyrtoi kërkesën buxhetore të ZRRE-së për vitin 2009, pas vërejtjeve të anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesit të MEF-it, i sugjeroi këtij agjensioni që të bëjë specifikimin e disa linjave buxhetore dhe brenda një kohë të shkurtër të përgatit versionin e ri të projektbuxhetit për vitin 2009, i cili më pas do të shqyrtohet dhe votohet nga Komisioni.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore për vitin 2009 të organizatave buxhetore në vijim:

3.3. Zyra e Auditorit Gjeneral

Haki Shatri, kërkoi prezantimin e shkurtër të Projektbuxhetit nga përfaqësuesit e ZAGJ-së.

Fatmir Uka, theksoi në përgatitjen e buxhetit kanë marrë pjesë në dëgjimet e organizuara nga MEF dhe me takimet që kanë pasur me ta kanë harmonizuar qëndrimet për kërkesën e tyre në të gjitha kategoritë ekonomike më përjashtim të një punëtori që nuk është lejuar (janë kërkuar 91 punëtor ndërsa MEF-i ka lejuar 90). Në këtë drejtim, kërkesa e jonë për këtë numër të punëtorëve mbështet edhe në planin e veprimit për partneritetit evropian, ekziston vendimi i Kryeministrit, por megjithatë, MEF-i e ka refuzuar.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Miratohet kërkesa buxhetore e Zyrës së Auditorit Gjeneral për vitin 2009 dhe Komisioni i propozon Kryesisë së Kuvendit të radhis për shqyrtim në seancën plenare.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore për vitin 2009 të organizatave buxhetore në vijim:

3.4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Haki Shatri, theksoi se në bazë të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2005/ që është në fuqi buxhetin e KGJK-së e shqyrton dhe miraton MEF-i, prandaj edhe i sugjerohet këtij agjensioni të procedojë kërkesën sipas dispozitave të kësaj rregullore.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR nxori këtë:

Q ë n d r i m

Komisioni shqyrtoi kërkesën buxhetore nr. 06/404-1076 të datës 17.09.2008 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2009 dhe i sugjeron Këshilli të dorëzon buxhetin vjetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 për Themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që rregullon mënyrën e procedimit dhe miratimit të buxhetit të këtij Këshilli.

4. Të ndryshme

Haki Shatri, njoftoi për përgatitjen e rekomandimit të Komisionit lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare për Kuvendin për vitin 2007. Kërkoi nga anëtarët të propozojnë ndonjë rekomandim shtesë nëse kanë si dhe të deklarohen për ato të propozuara.

Pasi që nuk kishte vërejtje dhe propozime, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni me shtatë vota PËR dhe një KUNDËR (znj. Besa Gaxherri dhe një ABSTENIM (znj. Kosara Nikolic në mungesë të materialit në gjuhën serbe) nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohet rekomandimi i Komisionit lidhur me raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Kuvendit të Kosovës për vitin 2007 dhe i propozohet Kryesisë së Kuvendit të radhis për shqyrtim në seancën plenare.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI